



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SHËRBIMI LEGJISLATIV
SHËRBIMI JURIDIK

Nr. 1221/3 Prot.

Tiranë, më 11.11. 2025

Lënda: Dërgim rezolute

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2024”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Niko PELESHI

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke theksuar se pavarësia dhe pluralizmi i mediave, transparenca e burimeve të financimit, si dhe transparenca e pronësisë së mediave kanë një rëndësi të veçantë në forcimin e demokracisë dhe integrimin evropian të vendit;

Duke konsideruar matjen e audiencës si një instrument të rëndësishëm për vetë operatorët, por dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen dhe transparencën e tregut audioviziv në Shqipëri;

Duke theksuar nxitjen dhe mbështetjen e standardeve profesionale të transmetimeve audiovizive përmes praktikave më të mira ndërkombëtare;

Për vitin 2024 vlerëson:

Punën e bërë nga AMA në kuadër të transparencës së strukturës së pronësisë nëpërmjet miratimit të rregullores “Për kërkesat dhe procedurat e rishikimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënave të pronësisë së OSHMA”, si dhe paraqitjen grafike në faqen web të AMA-s të transparencës e strukturës së pronësisë së shoqërive/individëve të pajisur me licencë/autorizim nga AMA dhe deklaratën e pronarit përfitues të këtyre subjekteve.

Punën e bërë nga AMA për realizimin e procesit të matjes së audiencës duke organizuar tri tryeza me ofrues të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) dhe agjenci komunikimi e marketingu, të cilat sollën si rezultat krijimin e Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI), funksionimi i të cilit do të mundësojë matjen e audiencës si një instrument i rëndësishëm për vetë operatorët, por dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen dhe transparencën e tregut audioviziv në Shqipëri.

Punën e bërë nga AMA për miratimin e rregullores “Për kërkesat e posaçme që ofruesit e Platformave të Shpërndarjes së Videove duhet të përmbushin për krijimin e ofrimit të sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim”, e cila është një akt i rëndësishëm nënligjor që trajton në mënyrë të posaçme rregullimin ligjor të Platformave të Shpërndarjes së Videove (PSV).

Bashkëpunimin ndërmjet AMA-s dhe platformës “Tik-Tok” në mbrojtje të përdoruesve shqiptarë të kësaj platforme lidhur me përmbajtje të dëmshme dhe komunikime tregtare, me qëllim piratimin e produktit audioviziv shqiptar. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, janë shqyrtuar në total nga ekipet e AMA-s 743 video për përmbajtje të dëmshme dhe 1513 për pirateri dhe në bashkëpunim me platformën “Tik-Tok” u arrit të hiqeshin 286 video me përmbajtje të dëmshme, 1505 video dhe 193 profile të raportuara për pirateri.

Punën e bërë nga AMA në drejtim të zbatimit nga ana e OSHMA-ve të Kodit të Ri të Transmetimit, veçanërisht pikat të cilat lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, që janë zgjeruar në Seksionin “Fëmijë në mediat audiovizive” dhe nënndarjet përkatëse.

Organizimin nga AMA të tryezës me temë: “Fol shqip – të mbrojmë dhe të duam gjuhën shqipe”, si pjesë e një fushate tepër të rëndësishme, pasi gjuha është tipar themelor i një kombi, prandaj atë duhet ta ruajmë dhe ta mbrojmë.

Punën e bërë nga AMA në lidhje me ndryshimet ligjore të propozuara në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të forcuar luftën kundër piraterisë televizive, ndryshime të cilat bëjnë të mundur përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* e BE-së në fushën e medias audiovizive.

Punën e bërë nga AMA si pjesë e grupit ndër-institucional të punës për lirimin e brezit digjital dividend dy (DD2), veçanërisht kontributin e saj në ofrimin e zgjidhjeve të përkohshme për trajtimin e problematikave të procesit.

Punën e bërë nga AMA në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve njerëzore të Autoritetit, përmirësimit të sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të rolit rregullator të saj.

Kuvendi i rekomandon AMA-s për vitin 2025:

1. Në kuadër të ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të rekomandimeve të BE-së, bazuar në praktikën e së drejtës evropiane mbi reklamën institucionale, të propozojë ndryshimet përkatëse në ligj, të cilat ndër të tjera rregullojnë procesin që AMA kryen lidhur me matjen e volumit të reklamës institucionale.

2. Me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit, të punojë për rritjen e kapaciteteve për monitorimin cilësor dhe sasior të transmetimeve audiovizive duke shtuar shqyrtimet që lidhen me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes, format e ndryshme të çrregullimeve në informacion, proceset zgjedhore etj.

3. Në kuadër të zbatimit të Kodit të ri të Transmetimit, duke patur parasysh, nga njëra anë, rritjen e ndjeshme të numrit të ankesave që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve (59.5% të ankesave krahasuar me 16.4% në 2023) dhe nga ana tjetër duke parë rritjen e ndjeshme të ankesave lidhur me shmangiet e tjera etike, ku përfshihen përdorimi i fjalorit joetik, pasaktësitë apo devijimet në ligjërim, apo moskuptimi i specifikave të gjinive mediatike etj., institucioni të tregojë vëmendje të veçantë lidhur me rastet e ankesave për të drejtat e fëmijëve dhe privatësisë së tyre, si dhe të marrë masa për intensifikimin e edukimit mediatik.

4. Të kërkojë që Ofruesit e Shërbimeve të Mediave Audiovizive të hartojnë plane veprimi mbi aksesin në mënyrë progresive në shërbimet e ofruara prej tyre nga personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ketë në vëmendje që pika e kontaktit në faqen e saj zyrtare për dhënien e informacionit dhe marrjen e ankesave për personat me aftësi të kufizuara të jetë funksionale dhe lehtësisht e arritshme prej tyre.

Miratuar në datën 30.10.2025